




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA



KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

**RREGULLORE MBI PROCEDURAT PËR ZHVILLIMIN, RISHIKIMIN DHE
APROVIMIN E KURRIKULAVE TË REJA**

Prishtinë, 2020



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

Në bazë të nenit 62 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi", Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi", me datë 24.12.2020, Senati Akademik miratoi këtë:

RREGULLORE MBI PROCEDURAT PËR ZHVILLIMIN, RISHIKIMIN DHE APROVIMIN E KURRIKULAVE TË REJA

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Më këtë rregullore përcaktohen procedurat për zhvillimin, rishikimin dhe aprovimin e kurrikulave në Kolegjin "Pjetër Budi" – Prishtinë.

II. Qëllimet e Rregullores

Neni 2

- 2.1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që Kurrikulat e Kolegjit "Pjetër Budi" të jetë në përputhje me trendet bashkëkohore të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (Procesi i Bolonjës), si dhe në përputhje me nevojat e ekonomisë së tregut për kuadro.
- 2.2. Sigurimi i një procesi koherent dhe transparent për hartimin e kurrikulave në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës, me praktikat më të mira në rajon e në Evropë dhe vendosja e një lidhjeje logjike ndërmjet synimeve të sistemit të arsimit të lartë dhe standardeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në një proces të konsultimeve aktive me partnerët socialë.

Neni 3

Objektivat

- 3.1. Të identifikohen nevojat e tregut dhe të shoqërisë për profesionistë në fusha të caktuara dhe të stimulohen hartimi i kurrikulave atraktive dhe në lëmenjtë deficitarë, si dhe në fushat me rëndësi të veçantë shoqërore;
- 3.2. Të themelohen drejtime dhe profile të reja studimore mbi bazën e nevojave të përcaktuara dhe në bazë të mundësive duke ruajtur nivelin e cilësisë, si dhe të zgjerohet spektri i shërbimeve arsimore në fushën e arsimit tërë jetësor;
- 3.3. Të përfillen ecuritë dhe procedurat e qasjes dhe metodologjisë evropiane Tuning¹ në procesin e hartimit të programeve studimore dhe të kurrikulave duke përcaktuar rezultatet e nxënies të shprehura në kompetenca gjenerike dhe specifike të profileve të caktuara.
- 3.4. Të sigurohen programe më fleksibile dhe më të individualizuara të studimeve përmes organizimit të tyre në module dhe në njësi të kurseve;
- 3.5. Të hartohen dhe të miratohen, përmes një qasjeje koherente, programet studimore

¹ Tuning është një program i mbështetur nga Komisioni Evropian që synon harmonizimin e strukturave të nxënies dhe të procedurave e të instrumenteve të hartimit e të rishikimit të kurrikulave. Kjo metodologji e vë theksin në kompetenca, rezultate të nxënies dhe në lidhjen e kredive ECTS me ngarkesën e punës së studentit.



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

për të dy nivelet e studimeve;

- 3.6. Të standardizohet terminologjia profesionale në fushën e kurrikulave në gjuhët studimore dhe të bëhet vetëdijesimi e aftësimi i personelit në këtë fushë.

III. Përkufizimet

Neni 4

- 4.1. "Kurrikulë" – nënkupton: një grup lëndësh nga një lëmi e përafërt që formojnë një Program Studimor (plan mësimor/shkencor).
- 4.2. "Viti akademik" përbëhet nga dy semestra. I pari fillon më 1 Tetor dhe mbaron në 15 Janar dhe semestri i dytë fillon më 15 Shkurt dhe mbaron më 15 Qershor.
- 4.3. "Kursi" nënkupton një modul studimi, me një vlerë të kredisë të shprehur si një numër i njësive të kredi, siç specifikohet në syllabuset përkatëse
- 4.4. "ETCS Kredi" ngarkesa akademike e studentit e shprehur në orë mësimore, ushtrime, punë praktike, etj., ashtu siç përcaktohen me Ligjin për Arsimin e Lartë, Udhëzimin për Implementimin e Sistemit ECTS, Statutin e Kolegjit dhe aktet tjera të brendshme.
- 4.5. "Grupi" – nënkupton grupin punues të ekspertëve të fushave të ndryshme të cilët zgjidhen nga Këshilli Mësimor Shkencor i Kolegjit.

IV. Parimet e hartimit të kurrikulave

Neni 5

Procesi i hartimit, zhvillimi, rishikimit të kurrikulave bazohet në parimet si vijon:

- 5.1. Lirinë akademike dhe autonominë e institucionit, Kolegji "Pjetër Budi" bartës privat i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës;
- 5.2. Udhëheqjen dhe menaxhimin e procesit nga institucioni dhe personeli arsimor – shkencor;
- 5.3. Respektimi i interesave të studentëve dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre aktive në këtë proces;
- 5.4. Integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL).

Neni 6

- 6.1. Kolegji "Pjetër Budi" do të sigurojnë të gjitha kushtet e resurset akademike, financiare, materiale e fizike për themelimin e programeve të reja ose për funksionimin e programeve ekzistuese. Njëkohësisht, gjatë hartimit të programeve do t'i kushtohet vëmendje e veçantë disenjimit dhe zbatimit cilësor të tyre.
- 6.2. Programet e studimeve do të jenë të qarta, të lexueshme, të matshme, të krahasueshme dhe, si të tilla, në funksion të lehtësimit të procesit të vlerësimit e të akreditimit.

Neni 7

Masat për sigurimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së programeve:

- 7.1. Rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe harmonizimi i tyre sipas metodologjisë dhe qasjes Tunning;



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

7.2. Udhëheqësit e programeve studimore, do të bëjnë përmirësimin dhe avancimin e rregullt të planprogrameve të veta me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe të përcjelljes së zhvillimeve akademike në fushën përkatëse shkencore;

7.3. Kolegji "Pjetër Budi" do të rishikojë në mënyrë periodike kurrikulat e njësive akademike me qëllim të përcjelljes në vazhdimësi të kërkesave të tregut të punës.

Neni 8

Programet Studimore të Kolegjit "Pjetër Budi" do të bazohen në:

8.1. Hulimtimin e mirëfilltë të nevojave dhe të rrjedhave të tregut të punës në vend dhe më gjerë;

8.2. Vlerësimin e prioriteteve zhvillimore të sistemit të arsimit në Kosovë;

8.3. Një proces të mirëfilltë të konsultimeve me palët e interesuara;

8.4. Potencialin ekzistues akademik, financiar dhe të infrastrukturës.

V. Procedura për rishikimin dhe miratimin e kurrikulave të reja

Neni 9

9.1. Udhëheqësit e programeve studimore përkatëse, obligohet të bashkëpunojë me stafin akademik dhe me studentët, dhe të përcjellë kornizën ligjore dhe dokumentet strategjike të sistemit të arsimit në Kosovë, rrjedhat e kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimet në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

9.2. Udhëheqësit e programeve studimore përkatëse, duke u bazuar në pyetësoret që plotësohen nga punëdhënësit dhe studentët, harton raportin i cili do të jetë bazë për azhurnimin e programeve ekzistuese, apo edhe hartimin e programeve të reja studimore.

9.3. Udhëheqësit e programeve studimore përkatëse, hartojë planin vjetor për hulumtime shkencore në pajtim me nevojat e tregut të punës për kuadro dhe përshtatjen e kurrikulave me këto nevoja.

9.4. Udhëheqësit e programeve studimore përkatëse, hartimin e raporteve e bëjnë në bashkëpunim me Zyren për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim.

9.5. Zyra për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim mund të bëjë hulumtime, anketa, studime, intervistime dhe aktivitete tjera që Prorektori për mësim, hulumtim dhe zhvillim akademik i konsideron të arsyeshme për të kuptuar më mirë nevojat e tregut dhe përshtatjen e këtyre nevojave me kurrikulat e Kolegjit.

Neni 10

10.1. Prorektori për mësim, hulumtim dhe zhvillim akademik, në bashkëpunim me udhëheqësit e programeve përkatëse, Zyren për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim, harton propozimet me shkrim për Rektoren për azhurnimin e programeve ekzistuese, apo edhe hartimin e programeve të reja studimore.

10.2. Rektori, i propozon Senatit të Kolegjit për miratim listen e programeve studimore që do të azhurnohen, apo edhe listen e programeve të reja që do të shvillohen.



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

10.3. Vendimi i Senatit në lidhje me zhvillimin e programeve të reja studimore i dërgohet për aprovim Bordit të Kolegjit.

10.4. Programet studimore ekzistuese të cilat do të azhurnohen, nuk ka nevojë të aprovimit nga ana e Bordit të Kolegjit. Vendimi i Senatit është i plotëfuqishëm dhe final.

10.4. Bordi i Kolegjit, me votim aprovon listën finale të programeve të reja që do të zhvillohen.

Neni 11

11.1. Pas vendimit pozitiv të Senatit, respektivisht Bordit të Kolegjit, Rektori formon grupin punues për azhurnimin e programeve studimore ekzistuese, apo zhvillimin e programeve të reja.

11.2. Grupi punues kryesohet nga Prorektori për mësim, hulumtim dhe zhvillim akademik i përbërë nga profesor, përfaqësuesit e studentëve, ekonomia dhe administrata. Sipas nevojës, mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm, vendor apo ndërkombëtar.

11.3. Numri i personave pjesë e grupit punues caktohet sipas nevojës caktohet nga Rektori.

11.4. Grupi punues, nëse nuk përcaktohet ndryshe me vendim të Rektorit, në afat prej 30 ditëve harton draft propozimet e programeve studimore ekzistuese të azhuruara, apo të programeve të reja.

11.5. Draft propozimet e programeve studimore ekzistuese të azhuruara, apo të programeve të reja, do të diskutohen me tërë stafin e Kolegjit, me pjesëmarrje të studentëve dhe përfaqësuesve nga ekonomia.

11.6. Pas diskutimit të prezantuar në pikën 11.5. të kësaj Rregullorje, Grupi punues i përfshin diskutimet dhe sugjerimet e arësyeshme dhe përpilon versionin final të programeve studimore ekzistuese të azhuruara, apo të programeve të reja.

11.7. Versioni/et finale të programeve studimore ekzistuese të azhuruara, apo të programeve të reja, dërgohen për kontroll dhe aprovim nga ana e Zyrës për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim.

11.8. Zyrës për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim, pas kontrollit të përbushjes së kriterëve formale të parapara nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA), dërgon për diskutim në Senat të Kolegjit.


11.9. Senati i Kolegjit merr vendim për programet studimore ekzistuese apo të reja që do të dërgohen për akreditim/riakreditim në AKA.

11.10. Pas vendimit pozitiv nga ana e Senatit, Zyra për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim, dërgon në AKA programet studimore ekzistuese apo të reja që do të nënshtrihen procesit të akreditimit/riakreditimit.

Neni 12

Kjo rregullore shfuqizon rregulloren mbi procedurat për zhvillimin, rishikimin dhe aprovimin e kurrikulave të reja.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Bordit të Kolegjit.

Rektori i Kolegjit

Prof. Ass. Dr. Artan Haziri

